

BRIF NGA DEBATI I ORGANIZATAVE RINORE DHE FORUMEVE RINORE TË PARTIVE POLITIKE:



UDHËRRËFYES PËR POLITIKAT RINORE 2024



British Embassy
Skopje



Partnership | Progress | Prosperity



Në mars të vitit 2024, Fondacioni për Demokraci i Westminsterit, në kuadër të projektit

“PRAKTIKO DEMOKRACI”

mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup, organizoi dy ngjarje ku të rinjtë kishin një vend qendror për të diskutuar politikat që janë të nevojshme për përmirësimin e jetës së këtij grupi demografik në vend.

Në ngjarjen “Udhërrëfyes për të rinjtë”, përfaqësuesit e organizatave rinore prezantuan rekomandimet e tyre të politikave për të rinjtë në fushat: standardi i të rinjve, cilësia e arsimit, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrja rinore. Në debatin publik midis forumeve rinore të partive politike, u debatuan dy tema: politikat rinore dhe tendencat demografike në vend. Ky brif përmbledh rekomandimet dhe idetë e shprehura në këto ngjarje nga të rinjtë se çfarë duhet të bëjnë institucionet për të përmirësuar jetën e bashkëqytetarëve të tyre të rinj në vend. Përmbledhja nuk pretendon të japë një pasqyrë të plotë të të gjitha prioriteteve për të rinjtë, por ofron një përmbledhje të asaj që këto organizata rinore dhe forumet rinore të partive politike e konsideruan si prioritet për të rinjtë në fillim të vitit 2024.



PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE TË ORGANIZATAVE RINORE TË SHOQËRISË CIVILE

Në ngjarjen Udhërrëfyese për të rinjtë, të mbajtur më 1 mars 2024, përfaqësuesit e organizatave rinore prezantuan pikëpamjet e tyre mbi fushat prioritare në të cilat duhet të ndërmerren veprime për të përmirësuar jetën e të rinjve. Fjalime hyrëse në ngjarjen kishin përfaqësues të organizatave: Shoqata për Hulumtim dhe Analiza (ShHA), Të Rinjtë Munden, Forumi Arsimor Rinor, Forumi për Ndryshime Arsimore (FECH), Unioni për Punë Rinore, Shoqata Rinore e të Shurdhërve dhe me Vështirësi në Dëgjim "Shenjë e Re", Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë dhe Koalicioni i Organizatave Rinore SEGA, ndërsa në diskutim morën pjesë edhe organizata dhe forume të tjera rinore të partive politike.




Rekomandimet nga ngjarja ishin si më poshtë:

ARSIMI

- Prezantimi i një praktike për të gjithë nxënësit në arsimin e mesëm formal, e cila nuk do të kufizohet vetëm në shkollat e mesme profesionale.
- Investimi në trajnime të rregullta për përmirësimin dhe përditësimin e kapaciteteve dhe njohurive të stafit mësimor.
- Përpilim në kohë, dorëzim dhe shpërndarje të teksteve shkollore.
- Prokurimi dhe sigurimi i materialeve arsimore, mjeteve ndihmëse dhe pajisjeve në shkolla, veçanërisht në shkollat e mesme profesionale.
- Rindërtimi dhe renovimi i shkollave që janë në gjendje të keqe, me qëllim të ofrimit të kushteve të mira për arsim.
- Rikonstruktimi i konvikteve të studentëve me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme të banimit dhe arsimit.
- Sigurimi i asistentëve arsimorë dhe mbështetja e stafit arsimor për punë me nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Sigurimi i stafit mësimor dhe arsimit të rregullt për të rinjtë në shtëpitë edukuese - korrektuese të cilët kanë qasje të kufizuara në mësimdhënie dhe stagnim në arsimimin e tyre.
- Kujdes për sigurimin e burimeve në shkolla në qytete më të vogla dhe zona rurale, për barazi më të madhe të mundësive për të gjithë të rinjtë, përfshirë ata jashtë kryeqytetit.
- Digjitalizimi i arsimit të lartë duke ofruar mundësi për regjistrim online, regjistrim të semestrit, indeks elektronik dhe shërbime të tjera për çështje studentore.
- Ndërmarrja e masave për çrrënjosjen dhe adresimin e korrupsionit në arsimin e lartë.
- Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe lidhja e universiteteve vendase me universitetet e tjera jashtë vendit.
- Krijimi i një strategjie afatgjatë për të lidhur në mënyrë efektive institucionet e arsimit të lartë me tregun e punës.
- Punësim real në sektorin publik për studentët që kanë përfunduar me sukses studimet jashtë vendit me bursë shtetërore.
- Zbatimi i vazhdueshëm i masave dhe politikave të parashikuara në fushën e arsimit në praktikë.

MUNDËSI TË BARABARTA

- Qendrat rinore dhe buxhetet për të rinjtë duhet të sigurohen në të gjitha komunat edhe atje ku ka një numër më të vogël të banorëve të rinj, sepse në ato komuna është edhe më urgjente të ofrohen mundësi për të rinjtë.
- Kujdes për të rinjtë me aftësi të kufizuara, si dhe të rinjtë që vijnë nga grupet në rrezik social, për të cilët aktualisht nuk ka pothuajse asnjë politikë të dedikuar.
- Ofrimi i mundësive për përparim akademik për personat me aftësi të kufizuara dhe vazhdimi i arsimit të lartë për ata të rinj me aftësi të kufizuara që kanë dëshirë të përfundojnë arsim të lartë.
- Promovimi dhe ndryshimet e Ligjit për përdorimin e gjuhës së shenjave në mënyrë që të adresohen më mirë nevojat e personave të shurdhër.
- Ofrimi i programeve për të rinjtë me aftësi të kufizuara nga Agjencia për Rini dhe Sport dhe financimi i duhur për ta.
- Zbatim konsekuent i politikave të miratuara rinore dhe alokimi i një buxheti adekuat për politikën rinore.



STANDARDI I TË RINJVE

- Vazhdimi i politikës "Garanci Rinore" dhe popullarizimi i saj si një masë për të përmirësuar standardin e të rinjve dhe punësimin.
- Prezantimi i përmbajtjes për të inkurajuar sipërmarrjen në arsimin formal.
- Ngritja e çështjes së standardit rinor duke miratuar Ligjin për standardin rinor.
- Politikat e qëllimshme për informim më mirë të të rinjve dhe për informim në lidhje me masat që zbatohen për ta dhe si t'i përdorin.
- Ndërtimi i konsensusit politik dhe jopartiak për çështjet me interes për të rinjtë dhe politikat që i prekin ata në fushat e arsimit, punësimit, shëndetësisë, kulturës, banimit dhe sfera të tjera.

PJESËMARRJA RINORE

- Integrimi i çështjeve rinore dhe pjesëmarrja në sektorë dhe politika të tjera që ndikojnë në jetën e të rinjve.
- Vendosja e konsultimit vjetor sistematik me format e organizimit rinor dhe organizatave rinore nga Qeveria.
- Përmirësimi dhe ndryshimet në Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore në konsultim me të rinjtë.
- Zbatimi i plotë i Ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore, siç është themelimi i asamblesë rinore dhe zgjedhja e organit këshillimor kombëtar.
- Ofrimi i mbështetjes për krijimin e këshillave rinorë lokalë në nivel komunal.
- Garantimi dhe rregullimi i organizimit të nxënësve në ligjin për arsimin e mesëm.
- Ndërmarrja e politikave dhe masave për përfshirjen e grave të reja dhe grupeve të marginalizuara në proceset e konsultimit politik dhe proceset e vendimmarrjes.
- Krijimi i politikave të përshtatshme demografike që do të trajtojnë faktorët që ndikojnë në emigracionin e të rinjve.
- Kryerja e komunikimit të qartë, të rregullt dhe të qasshëm nga institucionet për të rinjtë dhe me të rinjtë.
- Ofrimi i mbështetjes për organizatat rinore në vend.



PËRMBLEDHJE E PROPOZIMEVE TË FORUMEVE RINORE TË PARTIVE POLITIKE

Në ngjarjen **Debat midis përfaqësuesve të forumeve rinore të partive politike**, mbajtur më 7 mars 2024, përfaqësuesit e 11 forumeve rinore të partive politike prezantuan pikëpamjet dhe synimet e tyre për veprim, për të përmirësuar jetën e të rinjve. Në diskutim morën pjesë edhe forume të tjera rinore dhe përfaqësues të organizatave rinore.



Angazhimet dhe rekomandimet e paraqitura nga të rinjtë ishin si më poshtë:

POLITIKAT PËR TË RINJ

- Disa forume rinore të partive politike theksuan nevojën për ndryshime në Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikën rinore, si dhe zbatimin e tij të qëndrueshëm.
- Thjeshtimi i procedurave për krijimin dhe themelimin e këshillave rinorë lokalë, përmes ndryshimeve në Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikën rinore, me qëllim zbatimin më të mirë të ligjit dhe lehtësimin e procedurave për këshillat rinorë lokalë që janë themeluar.
- Buxhetimi i përmirësuar dhe më i lartë për zbatimin e politikave rinore dhe Ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikën rinore nga institucionet.
- Zbatimi i vazhdueshëm i Strategjisë Kombëtare Rinore 2023-2027 të miratuar kohë më parë.
- Mbështetja e krijimit të këshillave rinorë lokalë dhe rritja e numrit të tyre, nga dy të tretat aktuale të vetëqeverisjeve lokale, në vend.
- Përditësim në kohë dhe përgjegjësi nga institucionet për emërimin e nëpunësve rinorë. Punë në lidhje me profesionalizimin e pozicionit të nëpunësit rinor dhe kapaciteteve të personave që punojnë në këtë pozicion.
- Marrja e masave të tjera për të adresuar pjesëmarrjen e ulët të të rinjve.
- Mbështetja dhe vazhdimi i zbatimit të Garancisë Rinore është diçka që u theksua nga përfaqësuesit e disa forumeve rinore, si një politikë që siguron punësim, rikualifikim dhe trajnimin e të rinjve.
- Prezantimi i programeve për punësim për studentët më të mirë dhe më të suksesshëm nga universitetet publike.
- Prezantimi i një politike për 0% tatim personal për të rinjtë.
- Hapja e Qendrës për Kualifikime Profesionale dhe Fondacionit Rinor.
- Vendosja e mësimit praktik në arsimin e mesëm formal për të gjithë nxënësit.
- Fillimi i programeve të reja për të mbështetur sipërmarrjen.
- Mbështetja dhe promovimi i praktikës rinore me pagesë.
- Vendosja e "shtesës për të rinjtë", si mjete shtesë për të rinjtë.
- Mbështetja e organizimit të studentëve dhe nxënësve.
- Vendosja e organizimit të nxënësve të shkollave të mesme në Ligjin për arsimin e mesëm. Formimi i komuniteteve të shkollave të mesme në shkollat e mesme.
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme për mësimdhënie në fakultetet publike dhe zgjidhja e çështjes së ambienteve të atyre fakulteteve, objektet e të cilave janë në ndërtim e sipër.
- Sigurimi i institucioneve me informacione të qasshme dhe të kuptueshme për të rinjtë.
- Kuptimi i çështjeve që prekin të rinjtë si çështje për konsensus dhe bashkëpunimit mbipartiak.




TENDENCAT DEMOGRAFIKE TË VENDIT

- Prezantimi i politikave për lehtësimin e mundësive të të rinjve për banim të pavarur, siç është mbështetja financiare gjatë blerjes së banesave nga të rinjtë.
- Hapja e qendrave rinore për të mbështetur sipërmarrjen, edukimin dhe inovacionin midis të rinjtë.
- Politika për promovimin e cilësisë së arsimit dhe njohurive dhe aftësive të fituara.
- Krijimi i një strategjie për migrimin në vend, për përballje me tendencat e migracionit.
- Sigurim shëndetësor pa pagesë për të gjithë të rinjtë deri në moshën 29 vjeç.
- Përrjashtim nga tatimi personal për të rinjtë dhe sigurimi i lehtësimit tatimor gjatë punësimit të të rinjve.
- Përrjashtim nga pagesa e taksës administrative për të rinjtë.
- Stimulimi i partneriteteve publike-private.
- Ofrimi i trajnimit falas për zotërimin e aktiviteteve artizanale.
- Përrjashtim nga tatimi personale në industrinë e TI-së.
- Mbështetje për arsimin në fushat ku ka mungesë të stafit.







Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Praktiko demokraci" i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë çdo herë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.